

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 11, datë 24.12.2024

PËR TARIFAT QË ZBATOHEN NGA AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Në përputhje me nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 6, shkronja “e” dhe nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 53/2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, zëvendëskryeministri dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Neni 1

Fusha e veprimit

Ky udhëzim përcakton çështjet, të cilat janë subjekt i pagesës së një tarife për Autoritetin e Aviacionit Civil, tarifat konkrete dhe mënyrën se si ato do të paguhen.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi, përkufizimet e mëposhtme do të përdoren:

- a) “AAC” – nënkupton Autoriteti i Aviacionit Civil;
- b) “Detyrat certifikuese, licencuese apo autorizuese” – nënkupton çdo aktivitet të ndërmarrë (përfshirë atë mbikëqyrës) nga AAC-ja në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, për qëllime të lëshimit, mirëmbajtjes ose ndryshimit të certifikatave, licencave apo autorizimeve apo miratimeve të tjera, në zbatim të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- c) “Aplikant” – nënkupton çdo person fizik ose juridik që kërkon nga AAC-ja kryerjen e një detyrë certifikuese, licencuese apo autorizuese;
- ç) “Tarifë” – në kuptimin e këtij udhëzimi është një pagesë, e pagueshme për AAC-në, për kryerjen e një detyrë certifikuese, licencuese apo autorizuese prej saj;
- d) “Cikli i mbikëqyrjes” – nënkupton periudhën 12-, 24-, 36- apo 48-mujore, përgjatë së cilës AAC ushtron aktivitete mbikëqyrëse në zbatim të kërkesave rregullatore.

Neni 4

Përcaktimi i tarifave

1. Tarifat kërkohe dhe mblidhen nga AAC-ja vetëm në përputhje me këtë udhëzim.
2. Tarifat faturohen dhe si rregull, paguhen në monedhën lek. Për lejet e fluturimit, tarifa mund të paguhet edhe në vlerën EURO sipas vlerës së konvertimit të monedhës lek në monedhën EURO, të përcaktuar në kursin ditor, të publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e pagesës.

Neni 5

Pagesa e tarifave

1. Me kryerjen e detyrave licencuese, certifikuese, autorizuese e mbikëqyrëse, aplikanti do të paguajë tarifën e plotë brenda 30 ditëve, nga data e lëshimit të faturës.
2. AAC-ja mund të kërkojë likuidimin e faturës përpara kryerjes së detyrës.
3. Pagesa e kryer është e parimbursueshme.

Neni 6

Dështimi për të kryer pagesën

1. Kur pagesa për faturën nuk është kryer në kohën e duhur, atëherë AAC-ja ka të drejtë të aplikojë sanksione për pagesë të vonuar, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Kur pagesa nuk realizohet, AAC-ja ka të drejtë të zbatojë masat e mëposhtme, së bashku ose veçmas:

- a) të aplikojë sanksione për pagesë të vonuar, sipas legjislacionit në fuqi, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni;
- b) të refuzojë një aplikim;
- c) të ndalojë së trajtuari një aplikim.

Neni 7

Refuzimi i aplikimit dhe ndërprerja e kryerjes së detyrave të lidhura me aplikimet

1. Kur një aplikim refuzohet ose kryerja e detyrave të lidhura me aplikimin ndërpritet, tarifat e aplikueshme do të jenë të pagueshme plotësisht dhe nuk do të rimbursohen.

2. Kur pas një ndërprerjeje, AAC-ja rifillon kryerjen e detyrave menjëherë pas përfundimit të periudhës së ndërprerjes të kërkuar nga aplikanti ose më herët me kërkesë të aplikantit, AAC-ja do të kërkojë pagesën e një tarife të re.

3. Për qëllimet e këtij udhëzimi:

- a) ndërprerja e kryerjes së një detyre me kërkesë të aplikantit, merr fuqi në ditën e marrjes së kërkesës nga AAC-ja;
- b) ndërprerja e kryerjes së një detyre me iniciativë të AAC-së, merr efekt në datën kur vendimi i komunikohet aplikantit.

Neni 8

Detyrat subjekt tarifimi

1. Tarifat për detyrat e certifikimit, licencimit apo autorizimet e tjera, të paraqitura në aneksin 1 të këtij udhëzimi janë grupuar sipas fushave kryesore të aktivitetit të AAC:

- i) certifikimi/licencimi (në nivel organizate);
- ii) certifikimi /licencimi (në nivel individ);
- iii) mbikëqyrja (*Oversight*);
- iv) manuale (fillestare dhe të rishikuara);
- v) drone;
- vi) të tjera.

2. Tarifa për certifikimin e aerodromeve është kryer bazuar në kategorizimin e tyre mbështetur në numrin e pasagjerëve, si më poshtë:

- i) certifikimi i aerodromit me më shumë se 5 milionë pasagjerë/vit;
- ii) certifikimi i aerodromit me 3–5 milionë pasagjerë/vit;
- iii) certifikimi i aerodromit me 1–3 milionë pasagjerë/vit;
- iv) certifikimi i aerodromit me 200.000–1 milion pasagjerë/vit;
- v) certifikimi i aerodromit me më pak se 200.000 pasagjerë/vit.

3. Tarifa për miratimin e ofruesve të shërbimeve të përpunimit në tokë, është kategorizuar si më poshtë:

- i) miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta (për të gjithë listën e shërbimeve);
- ii) miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta (përpunimi i pasagjerëve);
- iii) miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (përpunimi i bagazheve);
- iv) miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (shërbimet e avionit);
- v) miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (karburanti dhe vajrat);
- vi) miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (mallrat dhe posta);
- vii) miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (katering).

4. Tarifa për certifikimin e operatorëve ajrorë dhe certifikatën e vlefshmërisë ajrore është kryer bazuar në kategorizimin e peshës së mjetit ajror, si më poshtë:
- i) avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) mbi 45.500 kg;
 - ii) avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 5.700 kg deri në 45.500 kg;
 - iii) avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 2.730 kg deri në 5.700 kg;
 - iv) avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) deri në 2.730 kg;
 - v) helikopter me shumë motorë, me peshë mbi 3.175 kg;
 - vi) helikopter me një motor, me peshë deri në 3.175 kg.
5. Tarifa për dhënien dhe vlefshmërinë e licencës së operimit do të kryhet bazuar në kategorizimin e mjetit ajror sipas ndënjësve/seats, si më poshtë:
- i) lëshimi AOL për herë të parë për avionë me më pak se 20 vende;
 - ii) lëshimi AOL për herë të parë për avionë nga 20–49 vende;
 - iii) lëshimi AOL për herë të parë për avionë nga 50–99 vende;
 - iv) lëshimi AOL për herë të parë për avionë nga 100–199 vende;
 - v) lëshimi AOL për herë të parë për avionë mbi 200 vende.
- Kur operatori ajror, i licencuar për operate nga AAC-ja, shton në flotën e vet avion/ë me numër vendesh më të madh nga ajo për të cilën është lëshuar licenca e operimit (AOL) ekzistuese, ai duhet të aplikojë për licencim të ri.
6. Tarifat për shërbimet e lundrimit ajror nuk janë përfshirë qëllimisht në këtë udhëzim. Kostot për këto shërbime mbulohen nga tarifa që AAC-ja mbledh nëpërmjet kostos për njësi, sipas kuadrit rregullator në fuqi për tarifën e shërbimeve të lundrimit ajror.
7. Tarifat për Sigurinë në Aviacion nuk janë të zbatueshme për programet e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, certifikimet dhe ricertifikimet e stafit të sigurisë për periudhën e Koncesionit, sipas Marrëveshjes Konkensionare.
8. Tarifa e Certifikatës së Instruktorit nuk është e aplikueshme për punonjësit e AAC-së.
9. Tarifa për rishikimin e manualeve të operatorëve është kryer bazuar në kategorizimin sipas numrit të faqeve si më poshtë:
- i) rishikim manuali 0–5 faqe;
 - ii) rishikim manuali 6–100 faqe;
 - iii) rishikim manuali 101–300 faqe;
 - iv) rishikim manuali 301–500 faqe;
 - v) rishikim manuali mbi 500 faqe.
10. Miratimi i manualeve për herë të parë përfshihet në detyrat e certifikimit/licencimit. Vlera e tyre e punës përfshihet në tarifën përkatëse të certifikimit/licencimit.
11. AAC nuk zbaton tarifë për testimet e kryera nga ekzaminuesit për subjektet e interesuara. Tarifa për testimet përcaktohet dhe mbledhet nga ekzaminuesi, ose organizata për të cilën punon ekzaminuesi. Ekzaminuesi ose organizata për të cilën punon ekzaminuesi do të paguajë për AAC-në shumën prej 10% të tarifës së mbledhur.
12. Për çdo detyrë që nevojitet të kryhet brenda periudhës kohore 1–3 ditë, duke përjashtuar proceset certifikuese dhe kur është e aplikueshme, tarifa do të jetë sa dyfishi i tarifës për afatin kohor të zakonshëm.
13. Të gjitha përjashtimet e dhëna nga AAC-ja, sipas legjislacionit në fuqi, ofrohen pa pagesë.

Neni 9

Dispozita të fundit tranzitore

1. Tarifat sipas këtij udhëzimi do të zbatohen nga data 1 janar 2025.
2. Me bërjen efektive të tarifave sipas këtij Udhëzimi, udhëzimi i përbashkët i ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe ministrit të Financave nr. 2225, datë 13.05.2013, “Për caktimin e tarifave të shërbimeve në Aviacionin Civil”, shfuqizohet.

Neni 10

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e udhëzimit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

ANEKSI 1
TARIFAT E DETYRAVE CERTIFIKUESE, LICENCUESE APO AUTORIZUESE

Nr.	DETYRAT CERTIFIKUESE SIPAS KATEGORIVE	TARIFA /LEK	AFATI
I	CERTIFIKIMI NË NIVEL ORGANIZATE		
	AERODROMET		
1	Certifikimi i aerodromit (për aeroportet me më shumë se 5 milionë pasagjerë/vit)	5,000,000	Në çdo rast aplikimi
2	Certifikimi i aerodromit (për aeroportet me 3-5 milionë pasagjerë/vit)	3,500,000	Në çdo rast aplikimi
3	Certifikimi i aerodromit (për aeroportet me 1-3 milionë pasagjerë/vit)	3,000,000	Në çdo rast aplikimi
4	Certifikimi i aerodromit (për aeroportet me 200.000 - 1 milion pasagjerë/vit)	2,200,000	Në çdo rast aplikimi
5	Certifikimi i aerodromit (për aeroportet me më pak se 200.000 pasagjerë/vit)	1,100,000	Në çdo rast aplikimi
6	Certifikimi i heliportit	300,000	Në çdo rast aplikimi
7	Regjistrimi i fushës së fluturimit	100,000	Në çdo rast aplikimi
8	Miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta (për të gjithë listën e shërbimeve)	1,000,000	Në çdo rast aplikimi
9	Miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta (përpunimi i pasagjerëve)	220,000	Në çdo rast aplikimi
10.	Miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (përpunimi i bagazheve)	220,000	Në çdo rast aplikimi
11	Miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (shërbimet e avionit)	220,000	Në çdo rast aplikimi
12	Miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (karburanti dhe vajrat)	400,000	Në çdo rast aplikimi
13	Miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (mallrat dhe posta)	220,000	Në çdo rast aplikimi
14	Miratimi i Ofruesve të Shërbimeve të Përpunimit në Tokë për palët e treta/vetëpërpunim (katering)	220,000	Në çdo rast aplikimi
	SIGURIA NË AVIACION		
15	Certifikatë për “Organizatë trajnimi për personelin e sigurisë në aviacionin civil”	130,000	Në çdo rast aplikimi
16	Rinovim të certifikatës për Organizatë Trajnimi për personelin e sigurisë së aviacionit	50,000	Në çdo rast aplikimi
17	Certifikatë për “Agjent i Rregullt i Kargos dhe Postës Ajrore”	130,000	Në çdo rast aplikimi
18	Ricertifikim për “Agjent i Rregullt i Kargos dhe Postës Ajrore”	65,000	Në çdo rast aplikimi
19	Certifikatë për “Furnizues i Rregullt i Furnizimeve në Fluturim”	130,000	Në çdo rast aplikimi
20.	Ricertifikim për “Furnizues i Rregullt i Furnizimeve në Fluturim”	65,000	Në çdo rast aplikimi

21	Certifikatë për “Dërgues i Njohur i Kargos dhe Postës Ajrore”	130,000	Në çdo rast aplikimi
22	Ricertifikim për “Dërgues i Njohur i Kargos dhe Postës Ajrore”	65,000	Në çdo rast aplikimi
23	Certifikatë për “Transportues Kargo ose Postë ACC3 që operon nga një aeroporti i një vendi të tretë drejt BE”	130,000	Në çdo rast aplikimi
24	Ricertifikim për “Transportues Kargo ose Poste ACC3 që operon nga një aeroporti i një vendi të tretë drejt BE”	65,000	Në çdo rast aplikimi
SIGURIA NË OPERIM			
25	Për shqyrtimin e aplikimit fillestar për lëshimin e një AOC-je kur aplikohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) mbi 45.500 kg	1,100,000	Në çdo rast aplikimi
26.	Për shqyrtimin e aplikimit fillestar për lëshimin e një AOC-je kur aplikohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 5.700Kg deri në 45.500 kg	880,000	Në çdo rast aplikimi
27.	Për shqyrtimin e aplikimit fillestar për lëshimin e një AOC-je kur aplikohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 2.730 kg deri në 5.700 kg	660,000	Në çdo rast aplikimi
28.	Për shqyrtimin e aplikimit fillestar për lëshimin e një AOC-je kur aplikohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) deri në 2.730 kg	660,000	Në çdo rast aplikimi
29.	Për shqyrtimin e aplikimit fillestar për lëshimin e një AOC-je kur aplikohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për Helikopter me shumë motorë, me peshë mbi 3.175 kg	440,000	Në çdo rast aplikimi
30	Për shqyrtimin e aplikimit fillestar për lëshimin e një AOC kur aplikohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për Helikopter me një motor, me peshë deri në 3.175 Kg	330,000	Në çdo rast aplikimi
31	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një tipi të ri avioni/helikopter shtesë në shtojcën e Certifikatës së Operatorëve Ajror (AOC) (OPS specs) dhe shtojcës së certifikatës për çdo lloj avioni/helikopter të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) mbi 45.500 kg	440,000	Në çdo rast aplikimi
32	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një tipi të ri avioni/helikopter shtesë në shtojcën e Certifikatës së Operatorëve Ajror (AOC) (OPS specs) dhe shtojcës së certifikatës për çdo lloj avioni/helikopter të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 5.700 kg deri në 45.500 kg	440,000	Në çdo rast aplikimi
33	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një tipi të ri avioni/helikopter shtesë në shtojcën e Certifikatës së Operatorëve Ajror (AOC) (OPS specs) dhe shtojcës së certifikatës për çdo lloj avioni/helikopter të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 2.730 kg deri në 5.700 kg	220,000	Në çdo rast aplikimi
34	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një tipi të ri avioni/helikopter shtesë në shtojcën e Certifikatës së Operatorëve Ajror (AOC) (OPS specs) dhe shtojcës së certifikatës për çdo lloj avioni/helikopter të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për avionët me peshë maksimale në ngritje	220,000	Në çdo rast aplikimi

	(MTOW) deri në 2.730 kg		
35	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një tipi të ri avioni/helikopter shtesë në shtojcën e Certifikatës së Operatorëve Ajror (AOC) (OPS specs) dhe shtojcës së certifikatës për çdo lloj avioni/helikopter të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për helikopter me shumë motorë me peshë mbi 3.175 kg	330,000	Në çdo rast aplikimi
36	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një tipi të ri avioni/helikopter shtesë në shtojcën e Certifikatës së Operatorëve Ajror (AOC) (OPS specs) dhe shtojcës së certifikatës për çdo lloj avioni/helikopter të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për helikopter me një motor me peshë deri në 3.175 kg	220,000	Në çdo rast aplikimi
37	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një avioni/helikopter shtesë të të njëjtit lloj në AOC (OPS SPECS) dhe shtimin e një certifikate për çdo avion /helikopter të ri që do të operohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) mbi 45.500 kg	220,000	Në çdo rast aplikimi
38	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një avioni/helikopter shtesë të të njëjtit lloj në AOC (OPS SPECS) dhe shtimin e një certifikate për çdo avion /helikopter të ri që do të operohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 5.700 kg deri në 45.500 kg	220,000	Në çdo rast aplikimi
39	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një avioni/helikopter shtesë të të njëjtit lloj në AOC (OPS SPECS) dhe shtimin e një certifikate për çdo avion /helikopter të ri që do të operohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 2.730 kg deri në 5.700 kg	150,000	Në çdo rast aplikimi
40	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një avioni/helikopter shtesë të të njëjtit lloj në AOC (OPS SPECS) dhe shtimin e një certifikate për çdo avion /helikopter të ri që do të operohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) deri në 2.730 kg	130,000	Në çdo rast aplikimi
41	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një avioni/helikopter shtesë të të njëjtit lloj në AOC (OPS SPECS) dhe shtimin e një certifikate për çdo avion /helikopter të ri që do të operohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për helikopter me shumë motorë me peshë mbi 3.175 kg	90,000	Në çdo rast aplikimi
42	Për shqyrtimin e një aplikimi për shtimin e një avioni/helikopter shtesë të të njëjtit lloj në AOC (OPS SPECS) dhe shtimin e një certifikate për çdo avion /helikopter të ri që do të operohet: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për helikopter me një motor me peshë deri në 3.175 kg	70,000	Në çdo rast aplikimi
43	Për shqyrtimin e një kërkesë për përfshirjen e një avioni shtesë të të njëjtit lloj, të regjistruar në një shtet të huaj, në shtojcën e Certifikatës së Operatorit Ajror (OPS SPEC) dhe shtesës së certifikatës për çdo avion të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) mbi 45.500 kg	110,000	Në çdo rast aplikimi
44	Për shqyrtimin e një kërkesë për përfshirjen e një avioni shtesë të të njëjtit lloj të regjistruar në një shtet të huaj, në shtojcën e Certifikatës së Operatorit Ajror (OPS SPEC) dhe shtesës së certifikatës për çdo avion të ri që	110,000	Në çdo rast aplikimi

	do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 5.700 kg deri në 45.500 kg		
45	Për shqyrtimin e një kërkesë për përfshirjen e një avioni shtesë të të njëjtit lloj të regjistruar në një shtet të huaj, në shtojcën e Certifikatës së Operatorit Ajror (OPS SPEC) dhe shtesës së certifikatës për çdo avion të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për fluturimet ndërkombëtare të rregullta për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) 2.730 kg deri në 5.700 kg	90,000	Në çdo rast aplikimi
46	Për shqyrtimin e një kërkesë për përfshirjen e një avioni shtesë të të njëjtit lloj të regjistruar në një shtet të huaj, në shtojcën e Certifikatës së Operatorit Ajror (OPS SPEC) dhe shtesës së certifikatës për çdo avion të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për avionët me peshë maksimale në ngritje (MTOW) deri në 2.730 kg	90,000	Në çdo rast aplikimi
47	Për shqyrtimin e një kërkesë për përfshirjen e një avioni shtesë të të njëjtit lloj të regjistruar në një shtet të huaj, në shtojcën e Certifikatës së Operatorit Ajror (OPS SPEC) dhe shtesës së certifikatës për çdo avion të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për helikopter me një motor me peshë deri në 3.175 kg	70,000	Në çdo rast aplikimi
48	Për shqyrtimin e një kërkesë për përfshirjen e një avioni shtesë të të njëjtit lloj të regjistruar në një shtet të huaj, në shtojcën e Certifikatës së Operatorit Ajror (OPS SPEC) dhe shtesës së certifikatës për çdo avion të ri që do të përfshihet gjatë operimit: Certifikatë e operatorit ajror (COA) për helikopter me shumë motorë me peshë mbi 3.175 kg	70,000	Në çdo rast aplikimi
49	Për pagesën e AOC-së: Një ndryshim në shkëmbimin e informacionit që nuk kërkon një vlerësim të sigurisë në operim të operatorit ajror (p.sh. emri, adresa) dhe heqja e një avioni nga AOC-ja.	20,000	Në çdo rast aplikimi
50	Për pagesën e AOC-së: Miratime shtesë të veçanta (<i>Short landing, Step approach</i>) etj.	180,000	Në çdo rast aplikimi
51	Për pagesën e AOC-së: Amendament për të përfshirë leje të tjera shtesë dhe një periudhë të nevojshme tranzicioni (DGR, LVTO, LVO, RVSM, EFB, PBN, ETOPS, MNPS etj.) sipas nën pjesës SPA	180,000	Në çdo rast aplikimi
52	Për operimet me rreze të gjatë të aeroplanëve me dy motorë (ETOPS): përfshirja e tipit të parë në aplikim	180,000	Në çdo rast aplikimi
53	Për operimet me rreze të gjatë të aeroplanëve me dy motorë (ETOPS): përfshirja e çdo lloji shtesë në aplikim	90,000	Në çdo rast aplikimi
54	Për operimet me rreze të gjatë të aeroplanëve me dy motorë (ETOPS): për miratimin e skemave individuale të punës dhe kohës së pushimit	90,000	Në çdo rast aplikimi
55	Për operimet me rreze të gjatë të aeroplanëve me dy motorë (ETOPS): për miratimin e një sistemi të menaxhimit të rrezikut të lodhjes FRMS	180,000	Në çdo rast aplikimi
56	Lidhur me miratimin e <i>Short Term Wet Lease</i>	40,000	Në çdo rast aplikimi
57	Lidhur me miratimin e <i>Wet Lease In</i>	80,000	Në çdo rast aplikimi
58	Lidhur me miratimin e <i>DRY lease</i>	110,000	Në çdo rast aplikimi
59	Lidhur me çdo ndryshim për kontrata <i>Wet lease</i> dhe <i>Dry Lease</i> (miratimi i ndryshimit ose plotësimit të kontratës kur përfshihet avioni shtesë, miratimi i zgjatjes së kontratës)	20,000	Në çdo rast aplikimi
60	Për operatorët e avionëve të cilëve u kërkohet të bëjnë deklaratat	40,000	Në çdo rast aplikimi
61	Për operatorët e avionëve që i nënshtrohen autorizimit për operacione speciale komerciale me rrezik të lartë SPO	110,000	Në çdo rast aplikimi
62	Për operatorët e avionëve që i nënshtrohen autorizimit	40,000	Në çdo rast aplikimi

	për operacione speciale komerciale me rrezik të lartë SPO Shqyrtimi i një kërkesë për ndryshimin e një leje për operacione speciale tregtare me rrezik të lartë pa ndryshim në procedurën standarde të funksionimit dhe ndryshim i lejes		
63	Për operatorët e avionëve të cilëve u kërkohet të paraqesin deklaratë në bazë të rregullave të detajuara për funksionimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit të tyre: 1–10 balona	40,000	Në çdo rast aplikimi
64	Për operatorët e avionëve të cilëve u kërkohet të paraqesin deklaratë në bazë të rregullave të detajuara për funksionimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit të tyre: më shumë se 10 balona	90,000	Në çdo rast aplikimi
65	Regjistrimi i përhershëm i një mjeti ajror në Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë: Me masë maksimale të certifikuar të ngritjes nën ose 2730 kg përfshirëse	40,000	Në çdo rast aplikimi
66	Regjistrimi i përhershëm i një mjeti ajror në Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë: Me një masë maksimale të certifikuar ngritjeje mbi 2730 kg, por jo më shumë se 5700 kg	50,000	Në çdo rast aplikimi
67	Regjistrimi i përhershëm i një mjeti ajror në Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë: Me një masë maksimale të certifikuar ngritjeje mbi 5700 kg, por jo më shumë se 45,500 kg	70,000	Në çdo rast aplikimi
68	Regjistrimi i përhershëm i një mjeti ajror në Regjistrin e Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë: Me një masë maksimale të certifikuar ngritjeje që kalon 45,500 kg	80,000	Në çdo rast aplikimi
69	Për çdo ndryshim lidhur me procesin e regjistrimit	20,000	Në çdo rast aplikimi
70	Lidhur me procesin e regjistrimit: Për lëshimin e një dublikati të certifikatës së regjistrimit të avionit ose certifikatës së regjistrimit të përkohshëm	20,000	Në çdo rast aplikimi
71	Lidhur me procesin e regjistrimit: Për rezervimin e markës së regjistrimit të avionit	20,000	Në çdo rast aplikimi
72	Lidhur me procesin e regjistrimit: Për zgjedhjen e shenjës së regjistrimit të avionit në momentin e regjistrimit	20,000	Në çdo rast aplikimi
73	Lidhur me procesin e regjistrimit: Për caktimin e një kodi transponder radari	50,000	Në çdo rast aplikimi
74	Lidhur me procesin e regjistrimit: Për autorizimin e ARC Staf	50,000	Në çdo rast aplikimi
75	Lëshimi i Certifikatës së Vlefshmërisë Ajrore: Avionë me peshë më të lehtë se 2730 kg MTOW	440,000	Në çdo rast aplikimi
76	Lëshimi i Certifikatës së Vlefshmërisë Ajrore: Avionë me peshë nga 2730 kg MTOW deri 5700 kg MTOW	880,000	Në çdo rast aplikimi
77	Lëshimi i Certifikatës së Vlefshmërisë Ajrore: Avionë me peshë nga 5700 kg MTOW deri në 45.500 kg MTOW	1,100,000	Në çdo rast aplikimi
78	Lëshimi i Certifikatës së Vlefshmërisë Ajrore: Avionë me peshë mbi 45.500 kg MTOW	1,540,000	Në çdo rast aplikimi
79	Lëshimi i Certifikatës së Vlefshmërisë Ajrore: Për helikopter me shumë motorë, me peshë mbi 3.175 kg	180,000	Në çdo rast aplikimi
80	Lëshimi i Certifikatës së Vlefshmërisë Ajrore: Për helikopter me një motor, me peshë deri në 3.175 kg	130,000	Në çdo rast aplikimi
81	Lëshim i Certifikatës së Zhurmave: Nxjerrja e Certifikatës së Zhurmave	40,000	Në çdo rast aplikimi
82	Për miratimin e një Organizate Mirëmbajtjeje dhe lëshimin e një certifikate miratimi të organizatës së mirëmbajtjes dhe aneksit të saj ose për miratimin e një organizate prodhuese dhe lëshimin e një certifikate miratimi të organizatës prodhuese dhe aneksin e saj (POA, DOA): kur kompania punëson nga 1 deri në 10 persona	220,000	Në çdo rast aplikimi
83	Për miratimin e një organizate mirëmbajtjeje dhe lëshimin e një certifikate miratimi të organizatës së mirëmbajtjes dhe aneksit të saj ose për miratimin e një	350,000	Në çdo rast aplikimi

	organizate prodhuese dhe lëshimin e një certifikate miratimi të organizatës prodhuese dhe aneksin e saj: kur kompania punëson nga 11 deri në 50 persona		
84	Për miratimin e një organizate mirëmbajtjeje dhe lëshimin e një certifikate miratimi të organizatës së mirëmbajtjes dhe aneksit të saj ose për miratimin e një organizate prodhuese dhe lëshimin e një certifikate miratimi të organizatës prodhuese dhe aneksin e saj: kur kompania punëson 51 e më shumë persona	530,000	Në çdo rast aplikimi
85	Për ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës së mirëmbajtjes ose shtojcës së saj ose ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese ose shtojcën e saj kur fushëveprimi i aktiviteteve rritet: kur kompania punëson nga 1 deri në 10 persona	40,000	Në çdo rast aplikimi
86	Për ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës së mirëmbajtjes ose shtojcës së saj ose ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese ose shtojcën e saj kur fushëveprimi i aktiviteteve rritet: kur kompania punëson nga 11 deri në 50 persona	70,000	Në çdo rast aplikimi
87.	Për ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës së mirëmbajtjes ose shtojcës së saj ose ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese ose shtojcën e saj kur fushëveprimi i aktiviteteve rritet: kur kompania punëson 51 e më shumë persona	110,000	Në çdo rast aplikimi
88	Për ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës së mirëmbajtjes ose shtojcës së saj ose ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese ose shtojcën e saj kur fushëveprimi i aktiviteteve rritet: Për ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës së mirëmbajtjes ose shtojcës së saj ose për ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës prodhuese ose shtojcës së saj ku ndryshimi nuk lidhet me zgjerimin e veprimtarisë	20,000	Në çdo rast aplikimi
89	Pranim i një organizate mirëmbajtjeje: Pranim i një organizatë 145	70,000	Në çdo rast aplikimi
90	Për lëshimin e një certifikate të miratimit të organizatës së menaxhimit të vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme dhe shtojcën e saj: kur kompania punëson deri në 10 persona	220,000	Në çdo rast aplikimi
91	Për lëshimin e një certifikate të miratimit të organizatës së menaxhimit të vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme dhe shtojcën e saj: kur kompania punëson më shumë se 10 persona	260,000	Në çdo rast aplikimi
92	Për ndryshimin e miratimit të organizatës së menaxhimit të vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme dhe shtojcës së tij kur rritet fushëveprimi i aktiviteteve: kur kompania punëson deri në 10 persona	90,000	Në çdo rast aplikimi
93	Për ndryshimin e miratimit të organizatës së menaxhimit të vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme dhe shtojcës së tij kur rritet fushëveprimi i aktiviteteve: kur kompania punëson 10 ose më shumë persona	110,000	Në çdo rast aplikimi
94	Për ndryshimin e certifikatës së miratimit të organizatës së menaxhimit të vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme dhe shtojcës së saj: Kur ndryshimi nuk përfshin një rritje të fushës së operimeve	20,000	Në çdo rast aplikimi
RREGULLIMI EKONOMIK			
95	Lëshimi AOL për avionë me më pak se 20 vende	140,000	Në çdo rast aplikimi
96	Lëshimi AOL për avionë nga 20-49 vende	230,000	Në çdo rast aplikimi
97	Lëshimi AOL për avionë nga 50-99 vende	350,000	Në çdo rast aplikimi
98	Lëshimi AOL për avionë nga 100-199 vende	475,000	Në çdo rast aplikimi
99	Lëshimi AOL për avionë baras ose më shumë se 200 vende	820,000	Në çdo rast aplikimi
100	Lëshim i AOL së rishikuar në rastet e cenimit të statusit ligjor ose në rastin e shkrirjes ose blerjes së aksioneve (si ndryshim adrese, administratori etj.).	44,000	Në çdo rast aplikimi
TRAJNIMI/ LICENCIMI I PERSONELIT TË			

	INDUSTRIË SË AVIACIONIT		
101	Certifikimi i organizatave të trajnimit të personelit të mirëmbajtjes / kontrollorët e trafikut ajror / për ekuipazhin e kabinës CCTO/ organizatave të aprovuara të trajnimit për pilotët (ATO)	150,000	Në çdo rast aplikimi
102	Certifikimi i organizatave të trajnimit për pilotët e deltaplan dhe paraglajd / për pilotët e avionit ultra të lehtë (ULA)/ për organizatat e deklaruara të trajnimit për pilotët (DTO)	40,000	Në çdo rast aplikimi
103	Miratimi i përdorimit të simulatorëve për qëllime trajnimi (FSTD/FTD/SDT... etj.)	88,000	Në çdo rast aplikimi
104	Autorizim për Qendrën Aeromjekësore (AeMC)	30,000	Në çdo rast aplikimi
105	Njohje e organizatave të aprovuara të trajnimit (ATO) të certifikuara/njohura nga EASA ose të certifikuara/njohur nga një shtet anëtar i EASA-së	10,000	Në çdo rast aplikimi
106	Njohje e organizatave të deklaruara të trajnimit (DTO) të certifikuara/njohura nga EASA ose të certifikuara/njohur nga një shtet anëtar i EASA-së	5,000	Në çdo rast aplikimi
107	Certifikimi i trupës së testimit të gjuhës.	40,000	Në çdo rast aplikimi
108	Njohje e certifikatës së trupës së testimit të gjuhës të lëshuara nga EASA-ja ose shtet anëtar i EASA-së	5,000	Në çdo rast aplikimi
II	MBIKËQYRJA		
	AERODROMET		
1	Mbikëqyrja e aerodromeve (për aeroportet me më shumë se 5 milionë pasagjerë/vit)	2,500,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
2	Mbikëqyrja e aerodromeve (për aeroportet me 3–5 milionë pasagjerë/vit)	1,750,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
3	Mbikëqyrja e aerodromeve (për aeroportet me 1–3 milionë pasagjerë/vit)	1,500,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
4	Mbikëqyrja e aerodromeve (për aeroportet me 200.000–1 milion pasagjerë/vit)	1,100,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
5	Mbikëqyrja e aerodromeve (për aeroportet me më pak se 200.000 pasagjerë/vit)	550,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
6	Mbikëqyrja e heliporteve	150,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
7	Mbikëqyrja e fushave të fluturimit	50,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
	SIGURIA NË OPERIM		
8	Mbikëqyrje / rinovim i AOC-së	440,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
9	Mbikëqyrja vjetore e autorizimit të fluturimeve speciale komerciale me rrezik të lartë, për operatorët e avionëve që i nënshtrohen autorizimit për operacione speciale komerciale me rrezik të lartë SPO	40,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
10	Rinovim vjetor i miratimeve, pranime të lëshuara për organizatën e menaxhimit të vlefshmërisë ajrore të vazhdueshme, të përfshira ose jo në AOC, organizatave të mirëmbajtjes ose ato prodhuese	110,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
III	CERTIFIKIMI NË NIVEL INDIVID		
	AERODROMET		
1	Njohje e instruktorëve	44,000	Në çdo rast aplikimi
	SIGURIA NË AVIACION		
2	Certifikatë e instruktorit të sigurisë	65,000	Në çdo rast aplikimi
3	Rinovim i certifikatës së instruktorit të sigurisë	13,000	Në çdo rast aplikimi
4	Certifikata për agjentët operacionale të sigurisë	4,500	Në çdo rast aplikimi

5	Rinovim i certifikatës për agjentët operacionalë të sigurisë (ricertifikim)	2,500	Në çdo rast aplikimi
6	Certifikatë për drejtuesit e sigurisë	25,000	Në çdo rast aplikimi
7	Rinovim i certifikatës për drejtuesit e sigurisë (ricertifikim)	10,000	Në çdo rast aplikimi
SIGURIA NË OPERIM			
8	Miratim për instruktorë DGR	70,000	Në çdo rast aplikimi
TRAJNIMI DHE LICENCIMI I PERSONELIT			
9	Licencë e pilotit të paragjajdit dhe deltaplanit, Licencë e pilotit të avionit ultra të lehtë (ULA)	10,000	Në çdo rast aplikimi
10	Rinovimi/zëvendësim i licencës së pilotit të paragjajdit dhe deltaplanit Rinovimi/zëvendësim i licencës së pilotit të avionit ultra të lehtë (ULA)	2,500	Në çdo rast aplikimi
11	Licencë e pilotit të avionit të lehtë (LAPL) / e pilotit privat (PPL) / e pilotit të planerit (SPL) / e pilotit të Balonës (BPL)	20,000	Në çdo rast aplikimi
12	Rinovimi/Zëvendësim i licencës së pilotit të avionit të lehtë (LAPL) / e pilotit privat (PPL) / e pilotit të planerit (SPL) / e pilotit të balonës (BPL)	5,500	Në çdo rast aplikimi
13	Licencë e pilotit tregtar (CPL) / e pilotit të transportit ajror (ATPL)	30,000	Në çdo rast aplikimi
14	Rinovimi/zëvendësim i licencës së pilotit tregtar (CPL) / e pilotit të transportit ajror (ATPL)	7,700	Në çdo rast aplikimi
15	Certifikata e validimit/rivalidimit për licencat e huaja (jo EASA)	30,000	Në çdo rast aplikimi
16	Dëshmia e ekuipazhit të kabinës	20,000	Në çdo rast aplikimi
17	Rimarrje/ridhënie e dëshmisë së ekuipazhit të kabinës	5,500	Në çdo rast aplikimi
18	Certifikata e vlerësuesit-ekzaminues të gjuhës / e instruktorit të fluturimit (FI) / e instruktorit të kategorizimit të tipit (TRI) / e ekzaminuesit të fluturimit (FE)/ tip/klas avioni / për fluturim natën (përveç lëshimit të parë të licencës ku përfshihet një nga kategoritë)	8,000	Në çdo rast aplikimi
19	Rinovimi/zgjatje e certifikatës së vlerësuesit-ekzaminues të gjuhës / e instruktorit të fluturimit (FI) / e instruktorit të kategorizimit të tipit (TRI) / e ekzaminuesit të fluturimit (FE)/ tip/klas avioni / për fluturim natën (përveç lëshimit të parë të licencës ku përfshihet një nga kategoritë)	1,800	Në çdo rast aplikimi
20	Certifikatë e instruktorit/ekzaminuesit të pilotit të paragjajdit dhe deltaplanit / e pilotit të avionit ultra të lehtë (ULA) Kategorizim për pilotin e paragjajdeve dhe deltaplaneve dyvendësh (tandem) / akrobatik / testues	4,000	Në çdo rast aplikimi
21	Rinovimi i Certifikatës së instruktorit/ekzaminuesit të pilotit të paragjajdit dhe deltaplanit / e pilotit të avionit ultra të lehtë (ULA) Kategorizim për pilotin e paragjajdeve dhe deltaplaneve dyvendësh (tandem) / akrobatik / testues	1,000	Në çdo rast aplikimi
22	Licencë kombëtare për mirëmbajtje avioni tipi I & II (inxhinieri/mekaniku) AML Pjesa 65	10,000	Në çdo rast aplikimi
23	Rinovimi/zëvendësim i licencës kombëtare për mirëmbajtje avioni tipi I & II (inxhinieri/mekaniku) AML Pjesa 65	2,500	Në çdo rast aplikimi
24	Lëshimi i licencës për kontrollor të trafikut ajror /kontrollor student të trafikut ajror	30,000	Në çdo rast aplikimi
25	Rinovimi/zëvendësimi i licencës për kontrollor të trafikut ajror /kontrollor student të trafikut ajror	7,700	Në çdo rast aplikimi
26	Lëshimi për kategoritë instruktor (ATCO)	8,000	Në çdo rast aplikimi
27	Rinovimi për kategoritë instruktor (ATCO)	1,800	Në çdo rast aplikimi
28	Njohja e licencave të huaja për KTA	30,000	Në çdo rast aplikimi
29	Autorizim për ekzaminuesi aeromjekësor (AME)	20,000	Në çdo rast aplikimi
IV MANUALET			
1	Manual fillestar (kur nuk përfshihet në certifikim)	100,000	Në çdo rast aplikimi

2	Rishikim Manuali 0 – 5 faqe	-	Në çdo rast aplikimi
3	Rishikim Manuali 6 – 100 faqe	30,000	Në çdo rast aplikimi
4	Rishikim Manuali 101 – 300 faqe	50,000	Në çdo rast aplikimi
5	Rishikim manuali 301 – 500 faqe	60,000	Në çdo rast aplikimi
6	Rishikim Manuali mbi 500 faqe	80,000	Në çdo rast aplikimi
V	DRONËT		
	SIGURIA NË OPERIM		
1	ID e operatorit	2,000	Në çdo rast aplikimi
2	LUC (<i>Light UAS Certificate</i>)	110,000	Në çdo rast aplikimi
3	Mbikëqyrje (LUC)	55,000	Në përputhje me ciklin e mbikëqyrjes së AAC-së (12,24,36,48 muaj)
4	Ndryshime në LUC	10,000	Në çdo rast aplikimi
5	Shtimi i një tipi të ri UAS-je	9,000	Në çdo rast aplikimi
6	Lëshimi i një Autorizimi për operim në kategorinë specifike bazuar në SAIL (<i>Specific assurance and Integrity Level</i>) dhe ARC (<i>Air Risk Class</i>) Sail 1-7, PDRA ose STS.	-	Në çdo rast aplikimi
	Sail – 1	10,000	Në çdo rast aplikimi
	Sail – 2	20,000	Në çdo rast aplikimi
	Sail – 3	40,000	Në çdo rast aplikimi
	Sail – 4	70,000	Në çdo rast aplikimi
	Sail – 5	90,000	Në çdo rast aplikimi
	Sail – 6	110,000	Në çdo rast aplikimi
	Sail – 7	130,000	Në çdo rast aplikimi
	PDRA bëhet nga autoriteti	110,000	Në çdo rast aplikimi
	PDRA bëhet nga operatori	40,000	Në çdo rast aplikimi
7.	Ndryshim emri, adrese biznesi apo personeli	5,500	Në çdo rast aplikimi
8.	Dhënia e lejes për udhëtime ndërkuftare	60,000	Në çdo rast aplikimi
9.	Lëshimi i një konfirmimi për operime ndërkuftare ose operime jashtë shtetit të regjistrimit të avionëve pa pilot në kategorinë specifike	20,000	Në çdo rast aplikimi
10.	Rishikimi i një deklarate operimi duke përfshirë konfirmimin e marrjes për funksionimin e UAS në kategorinë speciale bazuar në një skenar standard	20,000	Në çdo rast aplikimi
	TRAJNIMI DHE LICENCIMI I PERSONELIT		
11.	<i>Remote Pilot Certificate</i> A1/A3	3,000	Në çdo rast aplikimi
12.	Rinovim i certifikatës A1/A3	1,500	Në çdo rast aplikimi
13.	<i>Remote Pilot Certificate</i> A2	3,000	Në çdo rast aplikimi
14.	Rinovim i Certifikatës A2	1,500	Në çdo rast aplikimi
15.	<i>Remote Pilot Certificate</i> STS sipas UAS.STS-01.020 dhe UAS.STS-02.020	4,000	Në çdo rast aplikimi
16.	Rinovim i Certifikatës STS sipas UAS.STS-01.020 dhe UAS.STS-02.020	2,000	Në çdo rast aplikimi
17.	Verifikimi i operatorit për kryerjen e trajnimit praktik të pilotëve në distancë sipas shtojcës 3	5,000	Në çdo rast aplikimi
18.	Njohja e organizatave të trajnimit sipas STS-01/STS-02/PDRA	50,000	Në çdo rast aplikimi
19.	Zgjatja e njohjes së certifikatës së organizatës së trajnimit sipas STS-01/STS-02/PDRA	15,000	Në çdo rast aplikimi
VI	TË TJERA (që nuk përfshihen në kategorizimet e mësipërme)		
	AERODROMET		
1	Ndryshimi i certifikatës së aerodromit	100,000	Në çdo rast aplikimi
2	Ndryshimi i certifikatës së heliportit	41,000	Në çdo rast aplikimi
	SIGURIA NË OPERIM		
3	Për lëshimin e një lejeje speciale për fluturim (<i>Special permit to fly</i>) dhe një leje fluturimi (<i>Permit to fly</i>), me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: jo më shumë se 2730	40,000	Në çdo rast aplikimi

	kg.		
4	Miratim i kushteve të fluturimit me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: jo më shumë se 2730 kg	20,000	Në çdo rast aplikimi
5	Për lëshimin e një lejeje speciale për fluturim (<i>Special permit to fly</i>) dhe një leje fluturimi (<i>Permit to fly</i>), me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: që tejkalon 2730 kg, por jo më shumë se 5700 kg	70,000	Në çdo rast aplikimi
6	Miratim i kushteve të fluturimit me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: që tejkalon 2730 kg, por jo më shumë se 5700 kg	30,000	Në çdo rast aplikimi
7	Për lëshimin e një lejeje speciale për fluturim (<i>Special permit to fly</i>) dhe një leje fluturimi (<i>Permit to fly</i>), me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: që tejkalon 5700 kg, por jo më shumë se 45 500 kg	90,000	Në çdo rast aplikimi
8	Miratim i kushteve të fluturimit me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: që tejkalon 5700 kg, por jo më shumë se 45 500 kg	60,000	Në çdo rast aplikimi
9	Për lëshimin e një lejeje speciale për fluturim (<i>Special permit to fly</i>) dhe një leje fluturimi (<i>Permit to fly</i>), me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: më e madhe se 45 000 kg	110.000	Në çdo rast aplikimi
10	Miratim i kushteve të fluturimit me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: më e madhe se 45 000 kg	80,000	Në çdo rast aplikimi
11	Për lëshimin e një certificate eksporti të vlefshmërisë ajrore të një avioni me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: jo më shumë se 2730 kg	40,000	Në çdo rast aplikimi
12	Për lëshimin e një certificate eksporti të vlefshmërisë ajrore të një avioni me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: që tejkalon 2730 kg, por jo më shumë se 5700 Kg	60,000	Në çdo rast aplikimi
13	Për lëshimin e një certificate eksporti të vlefshmërisë ajrore të një avioni me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: që tejkalon 5700 kg, por jo më shumë se 45 500 kg	70,000	Në çdo rast aplikimi
14	Për lëshimin e një certificate eksporti të vlefshmërisë ajrore të një avioni me masë maksimale të certifikuar ngritjeje: më e madhe se 45 000 kg	80,000	Në çdo rast aplikimi
15	Për pagesën e AOC-së: konfirmimi i kopjes	4,400	Në çdo rast aplikimi
16	Për pagesën e AOC-së: lëshimi i një dublikate	8,800	Në çdo rast aplikimi
RREGULLIMI EKONOMIK			
17	Dhënie leje fluturimi për shërbime ajrore të programuara në sezone verë dhe dimër sipas IATA-s, si dhe për fluturime <i>charter</i> seri	10,000	Në çdo rast aplikimi
18	Dhënie leje fluturimi për shërbime ajrore të programuara shtesë në sezone verë dhe dimër sipas IATA, si dhe për fluturime <i>charter</i> seri shtesë	5,000	Në çdo rast aplikimi
19	Dhënie leje fluturimi për fluturime <i>ferry</i>	25,000	Në çdo rast aplikimi